



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 35 /2020  
Datë: 16/04 2020

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 mars 2019), nenit 52 par. 1 nën paragrafi 1.5 lidhur me nenin 55 par. 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) të Rregullores nr.05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (dt.19.02.2020), Ministria në detyrë e Drejtësisë, nxjerr:

#### V E N D I M

1. Shfuqizohet vendimi nr. 67/2017 i datës 19.05.2017, përkitazi me caktimin e shtesës në të ardhura personale për Kryeinspektorin e Ministrisë së Drejtësisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

#### A r s y e t i m

Me datë 19.05.2017, Ministria e Drejtësisë Dhurata Hoxha duke u bazuar në nenin 244 par. 3 të Ligjit Nr. 04/L-149, ka nxjerrë Vendimin Nr. 67/2017, me të cilin "Për kryerjen e detyrave të mbikëqyrjes në SHKK, i cakton Kryeinspektorit të Inspektoratit të MD-së shtesa në të ardhura personale në shumë prej 500 euro (me germa: pesëqind), në muaj". Po ashtu me këtë vendim "përjashtohet i lartpërmenduri nga shtesat për rrezikshmëri".

Në nenin 244 par. 3 të LESP përcaktohet se "Në kryerjen e detyrave të mbikëqyrjes inspeksionale, inspektori është i pavarur dhe ndërmer veprime në bazë të ligjit dhe të dispozitave tjera. Për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, Ministri me vendim përcakton shumën shtesë në të ardhura personale për inspektorët. Siç vërehet Ministria Dhurata Hoxha, duke u bazuar në pjesën e dytë të paragrafit 3 të nenit 244, konkretisht, në të cilin theksohet se për shkak të "rëndësisë" dhe "kushteve të veçanta të punës", ajo i ndanë si shtesë mujore kryeinspektorit shumën prej 500 eurove në muaj, e cila shumë nuk është paraparë në asnjë dispozitë ligjore apo nënligjore.

Neni 244 par. 3, përcakton se për rrethanat e rrezikshmërisë, rëndësisë dhe kushteve të veçanta të punës, Ministri nxjerrë vendim për shumën shtesë në të ardhurat personale për inspektorët, në këtë kuptim qëllimi i kësaj dispozite është që Ministri me anë të vendimit të përcaktoj shtesën në të ardhura personale për inspektorët në përgjithësi, nën kushtet e nenit 244 par. 3, por jo që me anë të vendimit, Ministri të përcaktoj shtesën për Kryeinspektorin dhe atë në vlerë prej 500 eurove.

Përveç kësaj, rëndësia dhe kushtet e veçanta të punës të cilat parashihen në pjesën e dytë të paragrafit 3 të nenit 244 dhe mbi të cilën ju kanë dhënë 500 euro shtesë mujore, nuk vlerësohen në mënyrë adekuate, për faktin se kryeinspektori në kryerjen e punës së tij nuk identifikohet në asnjë rrethanë me kushtet e veçanta të punës gjatë inspektimit në SHKK. Kësisoj sipas UA MD-NR. 11/2013 për mënyrën e kryerjes së inspektimit të brendshëm në Institucionet Korrektuese, parashihen qartë detyrat e inspektorëve dhe nuk ka ndonjë dispozitë ligjore që përcakton përshkrimin e kushteve të veçanta të punës si dhe shumën e përshkruar në vendim prej 500 eurove shtesë mujore.

Ajo që duhet të theksojmë dhe ritheksojmë është se shuma prej 500 euro mujore, e dhënë për kryeinspektorin e MD-së nuk parashihet në asnjë dispozitë të akteve juridike primare dhe sekondare. Kësisoj, kundërligjshëm me atë Vendim të lartpërmendurit nga dita e nxjerrjes së këtij vendimi, e deri më sot, i janë dhënë 17.500 euro si shtesë për një punë e cila është kryer në kushte normale.

Rëndësia dhe kushtet e veçanta të punës të cilat janë përcaktuar në nenin 244 par. 3 janë renditur pas termit "rrezikshmërisë". Rrezikshmëria si kategori i paraprindë për nga rëndësia kategorisë së kushteve të veçanta dhe rëndësisë së punës. Kësisoj kategoria e rrezikshmërisë në punë paguhet si shtesë maksimalisht 107 euro në muaj, e cila përcaktuar me nenin 6 par. 1 të UA MD-Nr. 08/2013. Pra, pagesa prej 500 eurove, nuk ka asnjë bazë ligjore ose nënligjore dhe për nga rëndësia paradoksalisht paguhet rreth 5 herë shumë se sa kategoria e rrezikshmërisë për punë.

Për këto arsye u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.



*Vendimi i dërgohet:*

- Kabinetit të Ministres;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Divizionit për Buxhet dhe Financa);
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.